



Bashkia Fier

Buxheti për Qytetarin 2022 - 2024

DISCLAIMER

Dokumenti bazohet në të dhënat e konsoliduara të Instrumentit të Planifikimit Financiar 2022 – 2024 dhe të dhënat e paraqitura në relacionin shoqërues të programit buxhetor afat – mesëm. Ky dokument është prodhuar nga Bashkia Fier me asistencën e Projektit Bashki të Forta.

Permbajtja

Fjalor Shpjegues	3
Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë	4
Vështrim mbi Buxhetin Afatmesëm 2022 - 2024	5
Burimet e Financimit	6
Shpenzimet Buxhetore	8
Administrimi i Bashkisë.....	10
Shërbime Publike Vendore	12
Arsimi Bazë dhe Parashkollor	16
Menaxhimi i Mbetjeve.....	19
Ujitja dhe kullimi.....	21
Trashëgimia Kulturore.....	23
Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	25

Fjalor Shpjegues

Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

Taksat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhet sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

Tarifat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

Transfertat e kushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

Transfertat e pakushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

Transfertat specifike

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

Trashëgimi nga viti i kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për cfarëdo zë apo projekt).

Shpenzime korrente

Këtu përfshihen të gjithë shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes, që kryen bashkia për një periudhë të caktuar kohore, për përmbushjen e funksioneve të përditshme. Përmes këtyre fondeve bashkia paguan pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve të bashkisë, shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes, grante, transferata për familjet në nevojë dhe që përfitojnë asistencë sociale sipas përcaktimeve ligjore, etj.

Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë

Bashkia Fier



Bashkia Fier kufizohet në veri me bashkinë Divjakë, në lindje me bashkitë Patos dhe Roskovec, ndërsa në jug me bashkinë Vlorë. Ajo shtrihet në Ultësirën Perëndimore, mes lumenjve Seman dhe Vlorë. Pjesa dërrmuese e bashkisë së re shtrihet në zonë fushore të ulët ndërsa komunat Cakran dhe Frakull kanë territor kodrinor. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Fierit.

Zhvillimi i Bashkisë Fier udhëhiqet nga parimet

e zhvillimit të qëndrueshëm dhe ka në fokus mirëqenien ekonomike dhe sociale të qytetarëve të saj, mbështetur në një mjedis të shëndetshëm dhe me aftësi vetë-ripërtëritëse.

Koncepti i zhvillimit të Fierit shkon përtej atij ekonomik, duke synuar gjithmonë e më tepër që ky i fundit të harmonizohet me mbrojtjen e burimeve natyrore, zbutjen e pabarazive sociale dhe, promovimin e zhvillimit intelektual, si shtylla që do të garantojnë që nga ky zhvillim të përfitojnë të gjithë qytetarët, duke menduar gjithmonë edhe për t'u trashëguar brezave të ardhshëm një territor të frytshëm e mjedis të shëndetshëm.

Bashkia Fier do të konsolidojë profilin e saj si pol i zhvillimit ekonomik rajonal, përmes diversifikimit të ekonomisë së saj dhe krijimit të kushteve për rritjen e konkurrueshmërisë së kësaj Bashkie në nivel vendi dhe më gjerë.

Misioni i bashkisë në funksion të realizimit të vizionit strategjik të zhvillimit është vënia në dispozicion në mënyrë inteligjente e të gjitha burimeve financiare e njerëzore për harmonizimin e interesave për zhvillim ekonomik e social në të gjithë territorin e Bashkisë.

Bashkia ka hartuar projekt buxhetin afatmesëm për tre vitet e ardhshme 2022 – 2024, përmes të cilit synon të vijojë punën arritjen e objektivave të mëposhtme:

- * Rritja e konkurrueshmërisë ekonomike të Bashkisë Fier, përmes mbështetjes së diversifikimit të profilit të saj ekonomik;
- * Mbështetje e sektorit të bujqësisë dhe turizmit, si sektorë kyçe për zhvillimin e ekonomisë lokale;
- * Mbrojtja dhe rigjenerimi i aseteve natyrore si elemente bazë të ripërtëritjes ekonomike dhe sociale;
- * Orientimi dhe kontrolli i zhvillimit urban përmes menaxhimit inteligjent të tokës dhe ofrimit të infrastrukturave të planifikuara në të gjithë territorin e Bashkisë Fier;
- * Zbutja e pabarazive sociale përmes përmirësimit të sistemit arsimor dhe atij shëndetësor

Vështrim mbi Buxhetin Afatmesëm 2022 - 2024

Bashkia ofron një buxhet realist dhe të ekuilibruar. Bashkia ka detyrime të prapambetura për të cilat ka hartuar planin për shlyerjen e plotë të tyre brenda vitit 2022, duke mos krijuar ndërkohë detyrime të reja. Aktualisht detyrimet e prapambetura përbëjnë 0.1% të ardhurave të përgjithshme të bashkisë.

Administrimi i bashkisë, shërbime publike vendore, arsimit bazë dhe parashkollor, menaxhimi i mbetjeve dhe trashëgimia kulturore zënë peshën më të madhe në financimin e buxhetit të bashkisë për tre vitet e ardhshme. Fondet për një pjesë të funksioneve të bashkisë janë përfshirë tek administrimi i bashkisë.

Bashkia ka bërë një shpërndarje të mirë të fondeve të investimeve duke planifikuar investime për funksione të ndryshme të bashkisë. Në këtë mënyrë, bashkia synon të përmirësojë një gamë të gjerë të shërbimeve / funksioneve të ofruara, si: infrastrukturën rrugore, furnizimin me ujë, arsimin, menaxhimin e mbetjeve, kulturën, shërbimet publike, ujitjen dhe kullimin etj. Fondet për investime do të zënë rreth 17% të buxhetit të përgjithshëm të bashkisë.

Hartimi i projekt buxhetit kaloi përmes një procesi të gjerë konsultimi nga administrata dhe Këshilli i Bashkisë. Si rezultat i këtij procesi, ky projekt buxhet tenton t'i përgjigjet nevojave të komunitetit, duke qenë se në të janë reflektuar një pjesë e konsiderueshme e rekomandimeve të mbledhura nga procesi i konsultimit.


Burimet e Financimit

FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2021	PLAN 2022	PLAN 2023	PLAN 2024
1,730,242	1,734,606	2,172,510	2,069,911	1,858,874	1,908,269

Kategoria	Burimi i financimit	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
TE ADHURA NGA BURIMET E VETA	Të ardhura nga taksat lokale	349,080	266,372	279,170	279,170	283,144	283,144
	Të ardhura nga taksat e ndara	108,472	118,275	142,058	142,058	143,478	149,154
	Të ardhura nga tarifa vendore	262,246	303,984	359,816	362,492	364,930	364,930
	Të ardhurat e tjera	27,329	15,751	30,884	30,884	31,198	31,198
TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR	Transferta e pakushtëzuar	493,983	549,748	599,977	618,189	641,336	685,055
	Trasferta specifike	286,405	284,502	394,788	387,118	394,788	394,788
TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR	Trashëgimi pa destinacion	202,727	195,974	365,817	250,000	0	0
TË ARDHURAT TOTALE		1,730,242	1,734,606	2,172,510	2,069,911	1,858,874	1,908,269


Viti 2019


TE ADHURA NGA BURIMET E VETA TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR HUAMARRJ TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR



Viti 2020

TE ADHURA NGA BURIMET E VETA TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR HUAMARRJ TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR





Dy fjalë mbi të ardhurat

Bashkia financohet në raportin rreth 51% me 49% nga të ardhurat e veta (përfshirë trashëgiminë nga viti shkuar) dhe transfertat e qeverisë qendrore. Bashkia siguron një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave nga burimet e veta, kryesisht nga taksat dhe tarifat vendore. Ky është një tregues pozitiv për punën e bashkisë, stabilitetin ekonomik dhe zhvillimin ekonomik lokal, duke ndikuar në uljen e varësisë nga të ardhurat që vijnë nga buxheti qendror.

Në tërësi për vitin 2022 bashkia planifikon:


- ✿ Të ardhurat e përgjithshme të bashkisë do të bien me 4.7%, si rezultat i uljes së të ardhurave nga buxheti qendror dhe fondit më të vogël të trashëguar nga viti i kaluar krahasuar me vitin 2021;
- ✿ Të ardhurat nga burimet e veta do të mbeten në të njëjtat nivele, me një rritje të lehtë prej 0.3% krahasuar me vitin e kaluar. Rritja do të ndikohet nga rritja e të ardhurave nga tarifat vendore, ndërkohë që të ardhurat nga taksat dhe të ardhurat e tjera, parashikohet të mbeten në të njëjtat nivele.

Shpenzimet Buxhetore

FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2021	PLAN 2022	PLAN 2023	PLAN 2024
1,730,209	1,605,441	2,172,509	2,069,910	1,858,874	1,908,269

Programi	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	826,689	891,772	1,233,477	1,043,081	925,608	975,003
Shërbime publike vendore	416,320	242,422	305,660	388,977	306,353	306,353
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	171,386	167,817	205,722	207,331	205,722	205,722
Menaxhimi i mbetjeve	140,061	139,414	193,683	186,307	188,758	188,758
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	57,412	48,973	68,400	67,456	68,400	68,400
Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	67,713	52,906	60,676	67,923	59,142	59,142
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	29,096	30,367	34,076	35,439	34,076	34,076
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	18,257	16,280	32,272	32,939	32,272	32,272
Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	0	12,107	26,000	27,040	26,000	26,000
Rrjeti rrugor rural	0	0	8,494	9,205	8,494	8,494
Administrimi i pyjeve dhe kullotave	3,275	3,383	4,049	4,212	4,049	4,049

	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Investimet	410,269	258,947	501,834	333,279	278,391	340,550
Shpenzimet korrente	1,319,940	1,346,494	1,670,675	1,736,631	1,580,483	1,567,719




Dy fjalë mbi shpenzimet

Shpenzimet buxhetore për vitin 2022 planifikohen 4.7% më pak se ato të vitit 2021. Rënia e buxhetit do të reflektohet në uljen e fondeve kryesisht për administrimin e bashkisë ndërkohë që për disa funksione të tjera bashkia ka planifikuar të rrisë buxhetin. Rritjen më të rëndësishme në krahasim me vitin 2021 do ta kenë këto shërbime që ofron bashkia:

- * *Shërbimet publike vendore;*
- * *Trashëgimia kulturore;*
- * *Rrjeti rrugor;*
- * *Administrimi i pyjeve dhe kullotave;*
- * *Kujdesi social;*
- * *Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, etj.*

Administrimi i Bashkisë

FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2021	PLAN 2022	PLAN 2023	PLAN 2024
826,689	891,772	1,233,477	1,043,081	925,608	975,003



	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Investimet	242,205	254,059	439,707	271,601	253,987	302,746
Shpenzimet korrente	584,484	637,713	793,770	771,480	671,621	672,257

Figura 1: Kategoritë e Shpenzimeve për Administrimin e Bashkisë.

Qëllimi i përgjithshëm: Bashkia synon ofrimin e një qeverisje vendore të përgjegjshme dhe një administratë të kualifikuar dhe transparente

E dhëna	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Numri total i punonjësve që punojnë për administratën e bashkisë	276	276	276	276	276	276
Punonjës të bashkisë në total	384	384	384	384	384	384

INVESTIMET E BASHKISË

Emërtimi i projektit	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Shpronësime për interes publik	17,000	5,517	6,506	16,387	20,000	40,000
Mbikqyrje punime	1,190	3,044	4,000	3,000	5,000	5,000
Furnizim vendosje panele fotovoltaike	38,039	37,489	57,489	18,213	25,000	25,000
Sistem survejimi për qendren "Horizont"	0	707	0	4,000	0	0
Blerje pajisje kompjuterike	0	8,785	6,000	9,000	10,000	10,000
Rikonstruksion rrugë të brendshme të bashkisë	0	69,937	148,940	110,000	82,043	121,506
Rikonstruksion shkollë Darzeze	0	8,903	10,000	18,615	0	0
Blerje godine Coca Cola	0	708	9,348	9,348	8,640	8,640
Ndërtim ujësjellesi Libofshe	0	7,999	16,124	10,582	0	0
Detyrime të prapambetura	0	0	3,000	0	3,000	3,000
Rikonstruksion ujësjellesash	0	0	0	0	35,171	34,360
Rikonstruksion shkollë Naun Kacaku Portez	0	0	7,462	2,693	0	0
Shtrim parketi dhe mobilim Pallati i Sportit	0	0	10,000	10,000	0	0
Ndërtim KUZ Libofshe	0	0	21,406	34,264	42,670	0
Ndërtim i pikës së transferimit të mbetjeve	0	0	8,000	19,176	0	0
Rehabilitim i unazës Skenderbeu unaza jugore	0	0	10,000	7,575	0	0
Rehabilitimi i gjanicës së segmentit Shtëpia E Oficerëve I 11 janari	0	0	0	0	6,792	30,000
Rikonstruksion qendra shëndetësore	0	0	0	0	10,000	17,740
Sistemi i vaditjes së spitalit Memorial	0	0	0	3,869	0	0

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka planifikuar shpenzime për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme për personelin, shërbime të përgjithme publike, marrëdhëniet me komunitetin, menaxhimin financiar, sigurimin shoqëror, shpenzime për ofrimin e shërbimeve që mbështesin veprimtarinë e kryetarit, këshillit dhe komisioneve të këshillit, bazat e të dhënave vendore etj. Gjithashtu, në këtë program përfshihen fonde për përmirësimin e disa shërbimeve të tjera si furnizimi me ujë, arsimit, shërbimet shëndetësore etj.


Performanca e administratës së bashkisë në ofrimin e këtyre shërbimeve do të përmirësohet me:

- ✱ Vendosjen e paneleve fotovoltaike;
- ✱ Rritjen e sigurisë përmes instalimit të sistemeve të survejimit;
- ✱ Rikonstruksionin e rrugëve të brendshme të bashkisë;
- ✱ Rikonstruksionin e disa godinave shkollore;
- ✱ Përmirësimin i rrjetit të furnizimit me ujë dhe shërbimeve sanitare;
- ✱ Përmirësim i kushteve për ofrimin e shërbimeve shëndetësore, etj.

Kjo falë punës dhe mbështetjes së vazhdueshme të bashkisë dhe investimeve që do të kryhen nga bashkia gjatë tre vjeçarit të ardhshëm.

Shërbime Publike Vendore

FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2021	PLAN 2022	PLAN 2023	PLAN 2024
416,320	242,422	305,660	388,977	306,353	306,353



	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Investimet	144,969	1,333	4,935	10,643	3,500	5,000
Shpenzimet korrente	271,351	241,089	300,725	378,334	302,853	301,353

Figura 2: Kategoritë e Shpenzimeve për Shërbimet Publike Vendore.

Qëllimi i përgjithshëm: Garantimi për të gjithë qytetarët shërbime publike cilësore në të gjithë territorin e saj pavarësisht vendndodhjes së tyre

Objektivat dhe treguesit e performancës	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024	Trendi
Km linear trotuar (ndryshimi vjetor në km linear)		11	0	1	0	0	
Raporti i sipërfaqes së gjelbër të mirëmbajtur kundrejt sipërfaqes totale të gjelbër	67.44	66.42	65.26	63.82	62.45	61.14	
Fondi i pemëve të bashkisë, diferenca në numër kundrejt vitit të kaluar		600	200	0	0	0	
Raporti në % i pemëve të mirëmbajtura kundrejt fondit total të pemëve të bashkisë	100	100	100	100	100	100	
Raporti në % i sipërfaqes publike të mbuluar me ndriçim kundrejt sipërfaqes totale të bashkisë	4.32	3.77	2.02	2.02	2.42	2.1	
Lekë të shpenzuara për 1 km ² hapësirë publike të ndriçuar / shpenzime operative dhe mirëmbajtje kundrejt sipërfaqes së mirëmbajtur me ndriçim	115863	404247	31056.7	60345.4	75562.9	71724.8	

Produkti	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Km linear trotuar të shtuar në vit		11	0	1	1	0
Sipërfaqe e gjelbëruar e shtuar (në m2)	7000	8000	10000	10000	10000	10000
Plane të hartuara për shërbimet publike	18	26	14	15	15	15
Fasada të rikonstruara	46	69	27	38	38	60
Sipërfaqe publike të rikonstruara (në m2)	15525	18290	5690	4800	4800	4800
Trotuarë të rikonstruuar (në km linear)	59	93	29	35	35	40
Sipërfaqe publike e mirëmbajtur në vit (në m2)	89250	17500	24970	25000	25000	25000
Numri i pemëve dekorative të mbjella në vit në hapësirat publike	600	200	0	0	0	0
Sipërfaqe e gjelbër e mirëmbajtur në vit (në m2)	290000	290250	290400	290400	290400	290400
Pemë dekorative të mirëmbajtura	15000	15600	15800	15800	15800	15800
Sipërfaqe e hapësirave publike e mbuluar me ndriçim në km2	26.8	23.4	12.5	12.5	12.5	13
Sipërfaqe publike e mbuluar me ndriçim e mirëmbajtur (në km2)	28.5	33	29	24	24	21

E dhëna	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Sipërfaqja totale e bashkisë (në km2)	619.9	619.9	619.9	619.9	619.9	619.9
Trotuarë në total (në km linear)	18	29	29	30	30	30
Sipërfaqe e gjelbër në total (në m2)	430000	437000	445000	455000	455000	475000

E dhëna	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Fondi i pemëve dekorative të bashkisë (në numër)	15000	15600	15800	15800	15800	15800
Shpenzime për mirëmbajtjen e ndriçimit (në lekë)	3302100	13340160	900643	1448289	1448289	1506221

INVESTIMET E BASHKISË

Emërtimi i projektit	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Makineri e pajisje	0	0	0	2,100	1,000	1,000
Inventar ekonomik	0	0	335	8,543	0	2,000
Mjete mekanike	0	1,095	4,000	0	2,500	2,000

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka planifikuar shpenzime për zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve publike vendore, hapësirave publike dhe të gjelbërta, mirëmbajtjen e trotuareve, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike dhe shërbime të tjera sipas nevojave dhe specifikave të bashkisë.


Performanca e bashkisë në ofrimin e shërbimeve publike vendore do të përmirësohet duke:

- ✱ Ritur sipërfaqen e trotuarëve për këmbësorët dhe përmirësuar ato ekzistuese përmes rikonstruksionit dhe mirëmbajtjes së tyre;
- ✱ Shtuar sipërfaqet publike të gjelbëruara;
- ✱ Mirëmbajtur pemët dekorative të bashkisë;
- ✱ Përmirësuar sipërfaqet publike përmes rikonstruksionit;
- ✱ Përmirësuar pamjen e qytetit përmes rikonstruksionit të fasadave;
- ✱ Ritur sipërfaqen publike të ndriçuar dhe mirëmbajtur sistemin ekzistues të ndriçimit publik, etj.

Kjo falë punës së bashkisë në ofrimin e shërbimeve publike, shtimit të fondeve dhe investimeve që do të kryhen nga bashkia.

Arsimi Bazë dhe Parashkollor

FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2021	PLAN 2022	PLAN 2023	PLAN 2024
171,386	167,817	205,722	207,331	205,722	205,722



	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Investimet	0	0	0	0	0	0
Shpenzimet korrente	171,386	167,817	205,722	207,331	205,722	205,722

Figura 3: Kategoritë e Shpenzimeve për Arsimin bazë dhe parashkollor.

Qëllimi i përgjithshëm: Përmirësimi i kushteve për ofrimin e arsimit bazë dhe parashkollor, rritja e numrit të fëmijëve të arsimuar.

Objektivat dhe treguesit e performancës	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024	Trendi
Raporti në % i ndërtesave të kopshteve/shkollave të mirëmbajtura kundrejt ndërtesave funksionale në total	26.47	26.47	21.43	21.43	21.43	21.43	➡
Raporti në % i ndërtesave të kopshteve / shkollave të arsimit bazë të	10.29	10.29	5.71	5.71	5.71	5.71	➡

Objektivat dhe treguesit e performancës	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024	Trendi
rikonstruktura, kundrejt ndërtesave funksionale në total							
Raporti në % i numrit të fëmijëve që frekuentojnë sistemin parashkollor kundrejt numrit total të fëmijëve 3 - 6 vjeç	51.95	63.99	55.45	55.45	55.45	55.45	➔
Numri mesatar i nxënësve për çdo punonjës mësues	12.16	11.84	11.79	11.79	11.79	11.79	➔
Numri mesatar i nxënësve të arsimit bazë në një klasë	12.72	18.12	17.88	17.88	17.88	17.88	➔
Numri mesatar i fëmijëve për një punonjës mësues në arsimin parashkollor	16.56	15.38	15.06	15.06	15.06	15.06	➔
Numri mesatar i fëmijëve në një klasë të parashkollorit	21.29	19.48	18.8	18.8	18.8	18.8	➔

Produkti	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Ndërtesa të arsimit bazë dhe parashkollor të mirëmbajtura	18	18	15	15	15	15
Kopshte / shkolla 9 vjeçare të rikonstruktura	7	7	4	4	4	4
Shkolla / kopshte në të cilat është siguruar ngrohja	68	68	70	70	70	70
Numri i objekteve shkollore të siguruar	25	25	26	26	26	26

E dhëna	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Numri i fëmijëve të moshës 3 - 6 vjeç	5449	4110	4646	4646	4646	4646
Ndërtesa funksionale të arsimit bazë dhe parashkollor	68	68	70	70	70	70

E dhëna	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Nxënës të regjistruar në arsimin 9-vjeçar	7481	10671	10458	10458	10458	10458
Mësues në sistemin parashkollor	171	171	171	171	171	171
Numri i mësuesve në sistemin e arsimit bazë	615	901	887	887	887	887
Klasa në sistemin parashkollor	133	135	137	137	137	137
Klasa në sistemin e arsimit bazë	588	589	585	585	585	585
Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor	2831	2630	2576	2576	2576	2576
Numri i nxënësve që përfundojnë sistemin e arsimit bazë (9 vjeçar)	1256	1201	1179	1179	1179	1179
Staf mbështetës në arsimin parashkollor	49	49	53	53	53	53

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit


Bashkia ka planifikuar shpenzime për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e strukturave shkollore dhe kopshteve, pagesën e mësuesve të kopshteve dhe stafit mbështetës, si dhe mbështetje të programeve mësimore për trajnimin e edukatorëve dhe mësuesve.

Performanca në ofrimin e shërbimit të arsimit bazë dhe parashkollor do të përmirësohet duke përmirësuar kushtet në kopshte dhe shkolla dhe mbështetur zhvillimin e mësimin sipas standardeve ligjore të përcaktuara. Në këtë drejtim, parashikohet që numri i fëmijëve / nxënësve në klasa dhe i fëmijëve / nxënësve për mësues të jetë brenda standardeve të përcaktuara.

Për përmirësimin e shërbimit të arsimit bazë dhe parashkollor, bashkia ka planifikuar investime për rikonstrukcione të ndërtesa shkollore, mirëmbajtjen e vazhdueshme të tyre, sigurimin e ngrohjes, etj.

Menaxhimi i Mbetjeve

FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2021	PLAN 2022	PLAN 2023	PLAN 2024
140,061	139,414	193,683	186,307	188,758	188,758



	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Investimet	11,513	338	20,802	30,326	6,850	18,850
Shpenzimet korrente	128,548	139,076	172,881	155,981	181,908	169,908

Figura 4: Kategoritë e Shpenzimeve për Menaxhimin e Mbetjeve.

Qëllimi i përgjithshëm: Mbulimi i gjithë territorit të bashkisë me menaxhim të mbetjeve bashkiake

Objektivat dhe treguesit e performancës	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024	Trendi
Raporti në % i sipërfaqes së mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve kundrejt sipërfaqes totale të bashkisë	82.59	82.59	82.59	82.59	82.59	82.59	➔
Raporti në % i koshave/kazanëve të mirëmbajtur ndaj koshave/kazanëve në total	100	100	100	100	100	100	➔

Objektivat dhe treguesit e performancës	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024	Trendi
Mbetje të grumbulluara dhe transportuara në vit, ndryshimi vjetor në ton		400	-400	0	0	0	

Produkti	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Sipërfaqe e mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në km2	512	512	512	512	512	512
Sasia totale e mbetjeve të grumbulluara dhe transportuara në ton	3500	3900	3500	3500	3500	3500
Kosha / kazanë mbeturinash të mirëmbajtur / dezinfektuar	750	900	900	900	900	900
Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve në zonat urbane (ditë në javë)	7	7	7	7	7	7
Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve në zonat rurale (ditë në javë)	3	3	3	3	3	3

E dhëna	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Kazane plehrash në total	750	900	900	900	900	900
Pika të vendqëndrimit të kontenierëve për grumbullimin e mbetjeve	375	450	450	450	450	450
Makineri pastrimi në total	8	8	8	8	8	8
Sipërfaqja totale e bashkisë (në km2)	619.9	619.9	619.9	619.9	619.9	619.9

INVESTIMET E BASHKISË

Emërtimi i projektit	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Inventar ekonomik	0	338	802	17,526	0	0

Emërtimi i projektit	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Makineri e pajisje	0	0	15,000	12,800	5,850	15,850
Peme dekorative	0	0	5,000	0	1,000	3,000

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit


Bashkia ka planifikuar shpenzime administrimin, mbikëqyrjen, inspektimin dhe organizimin e sistemeve të grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve, pastrimin e rrugëve, parqeve etj.

Performanca në ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve do të përmirësohet duke realizuar:

- * Shtuar makineri dhe pajisje për ofrim cilësor të shërbimit;
- * Mbledhur dhe transportuar me frekuencë të lartë mbetjet;
- * Përmirësuar kushtet e grumbullimit të mbetjeve, etj.

Kjo falë investimeve që do të kryhen dhe punës së bashkisë në këtë sektor.



Ujitja dhe kullimi



	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Investimet	0	0	960	5,504	960	960
Shpenzimet korrente	57,412	48,973	67,440	61,952	67,440	67,440

Figura 5: Kategoritë e Shpenzimeve për Ujitjen dhe Kullimin.

Qëllimi i përgjithshëm: Shtimi i prodhimeve bujqësore përmes shtimit të sipërfaqeve të mbuluara me sistem ujitës dhe kullues

Objektivat dhe treguesit e performancës	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024	Trendi
Km kanal vaditës të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve ujitëse në pronësi të bashkisë (në %)	1.02	1.47	1.69	1.79	1.89	1.95	
Km kanal kullues të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve kulluese në pronësi të bashkisë (në %)	9.69	8.73	8.61	8.66	8.7	8.92	

Produkti	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Shtim i sipërfaqes bujqësore të mbuluar me ujitje (në ha)	757	1203	1206	1208	1208	1217
Shtim i sipërfaqes bujqësore të mbuluar me kullim (në ha)	5851	5890	5892	5891	5891	5894
Km kanal kullues të pastruar	213.9	192.78	194	195	195	197
Km kanal ujitës të pastruar	19.27	27.91	33	35	35	38
Familje përfituese nga shërbimi i ujitjes dhe kullimit	42321	44520	44750	45125	45125	46125
Diga dhe rezervuarë të mirëmbajtur	0	0	0	1	1	1

E dhëna	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Sipërfaqe e tokës bujqësore e mbuluar me sistem ujitës (në ha)	15220	15795	16200	16320	16320	16700
Sipërfaqe e tokës bujqësore e mbuluar me sistem kullues (në ha)	35437	35640	35930	36100	36100	36900
Rrjet ujitës në pronësi të bashkisë në total në km	1896	1905	1953	1953	1953	1953
Rrjet kullues në pronësi të bashkisë në total në km	2208	2208	2253	2253	2253	2209
Diga dhe rezervuarë në total	15	15	15	15	15	15

INVESTIMET E BASHKISË

Emërtimi i projektit	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Investime	960	960	960	5,503	960	960

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka planifikuar shpenzime për ndërtimin dhe organizimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit, si dhe administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e kësaj infrastrukture gjatë tre viteve të ardhshme.


Performanca në ofrimin e shërbimit të ujitjes dhe kullimit do të përmirësohet duke:

- ✿ Pastruar më shumë kanale ujitëse dhe kullues;
- ✿ Shtuar sipërfaqen bujqësore të mbuluar me ujitje dhe kullim;
- ✿ Shtuar numrin e familjeve fermere që përfitojnë nga shërbimi i ujitjes dhe kullimit;
- ✿ Mirëmbajtur digat dhe rezervuarët, etj.

Kjo falë investimeve dhe punës që do të kryhet nga bashkia për realizimin e këtij shërbimi.

Trashëgimia Kulturore

FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2021	PLAN 2022	PLAN 2023	PLAN 2024
67,713	52,906	60,676	67,923	59,142	59,142



	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Investimet	69	2,172	2,134	2,000	600	500
Shpenzimet korrente	67,644	50,734	58,542	65,923	58,542	58,642

Figura 6: Kategoritë e Shpenzimeve për Trashëgiminë Kulturore

Qëllimi i përgjithshëm: Përmirësimi i jetës kulturore të komuniteti, ruajtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore

Objektivat dhe treguesit e performancës	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024	Trendi
Numri i shfaqjeve kulturore; artistike të mbështetura me fondet e bashkisë (ndryshimi vjetor në numër)		0	72	5	0	0	↑

Produkti	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Numri i shfaqjeve kulturore; evente artistike të mbështetura me fondet e bashkisë			72	77	77	77

INVESTIMET E BASHKISË

Emërtimi i projektit	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Inventar ekonomik	0	2,172	2,134	2,000	600	600


Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka planifikuar shpenzime për zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve, zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e bibliotekave, muzeumeve, teatrove etj. Bashkia do të planifikojë dhe mbështesë organizimin e ngjarjeve kulturore.

Performanca e bashkisë në ofrimin e shërbimeve të trashëgimisë kulturore do të përmirësohet. Bashkia planifikon të realizojë më shumë shfaqje kulturore, evente artistike, aktivitete promovuese, panaire etj, për kulturën;

Kjo falë mirëadministrimit të fondeve në dispozicion të kulturës, punës së punonjësve të bashkisë dhe investimeve që do të kryhen nga bashkia në këtë sektor.

Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile



	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Investimet	0	0	0	0	0	0
Shpenzimet korrente	29,096	30,367	34,076	35,439	34,076	34,076

Figura 7: Kategoritë e Shpenzimeve për Mbrojtjen dhe zjarri dhe shpëtimi

Qëllimi i përgjithshëm: Bashkia synon të ulë rastet e zjarreve, përmbytjeve dhe fatkeqësive natyrore.

Objektivat dhe treguesit e performancës	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024	Trendi
Numri i rasteve të menaxhuara për shuarjen e zjarrit (ndryshimi vjetor në numër)		0	69	0	0	0	➔

Produkti	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Raste të menaxhuara për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimit	281	281	350	350	350	350

E dhëna	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Punonjës të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi	30	30	30	30	30	30
Numri i stacioneve mzsh	1	1	1	1	1	1
Numri i makinave zjarrfikëse	2	2	2	2	2	2

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka planifikuar shpenzime për të siguruar funksionimin e njësisë zjarrfikëse dhe shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit, shërbimet e mbrojtjes

civile, si evakuimi i zonave të përmytura etj, si dhe rritjen e kapaciteteve të punonjësve dhe ndërgjegjësimit në komunitet përmes programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit.

Performanca në ofrimin e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe mbrojtjes civile parashikohet e qëndrueshme. Bashkia do të angazhohet me profesionalizëm në menaxhimin e rasteve të zjarreve dhe shpëtimit në të gjithë territorin e saj.